



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 21

1 mars

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.117, datë 13.2.2013	Për kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje.....	843
Udhëzim i MD, MB, PP nr.827/7, datë 28.2.2013	Për bashkëpunimin ndërinstitucional, në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.....	855

VENDIM
Nr. 117, datë 13.2.2013

**PËR KRITERET, NË BAZË TË TË CILAVE PËRCAKTOHET KUR DISA TIPA TË
METALIT SKRAP PUSHOJNË SË QENI MBETJE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Për qëllimet e këtij vendimi, do të përdoren, përveç termave të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, edhe përkufizimet e mëposhtme:

- a) “Skrap i hekurit dhe i çelikut”, skrap, i cili përbëhet kryesisht nga metal hekuri dhe çeliku;
- b) “Skrap alumini”, skrap i cili përbëhet kryesisht nga metal alumini dhe aliazhet e tij;
- c) “Mbjajtës”, një person, fizik ose juridik, i cili posedon l (një) skrap;
- ç) “Prodhues”, mbajtësi që transferon skrap te një mbajtës tjetër për herë të parë, si skrap i cili ka pushuar së qeni mbetje;
- d) “Importues”, çdo person, fizik ose juridik, i licencuar sipas legjislacionit në fuqi, i cili importon skrap, që ka pushuar së qeni mbetje në vendin nga i cili importohet;
- dh) “Staf i kualifikuar”, staf, i cili është kualifikuar nga përvoja ose trajnimi për të monitoruar dhe vlerësuar cilësitë e skrapit;
- e) “Inspektim vizual”, inspektim i skrapit, që mbulon të gjitha pjesët e një dërgese dhe që përdor shqisat njerëzore ose ndonjë pajisje të paspecializuar;
- ë) “Dërgesë”, një sasi skrap, i cili synohet për livrim nga një prodhues te një mbajtës tjetër dhe që mund të përmbahet në një ose disa njësi transporti, si kontejnerët.

II. Kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur pushojnë së qeni mbetje skrap i hekurit dhe i çelikut

Skrap i hekurit dhe i çelikut do të pushojë së qeni mbetje aty ku, me transferimin nga prodhuesi te një mbajtës tjetër, plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) mbetjet e përdorura si input për operacionin e rikuperimit janë në përputhje me kriteret e parashikuara në seksionin 2 të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) mbetjet e përdorura si input për operacionin e rikuperimit janë trajtuar në përputhje me kriteret e parashikuara në seksionin 2 të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi;
- c) skrap i hekurit dhe i çelikut, që rezulton nga operacioni i rikuperimit, janë në përputhje me kriteret e parashikuara në seksionin 1 të aneksit I, bashkëlidhur këtij vendimi;
- ç) prodhuesi ka plotësuar kërkesat e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të kreut V të këtij vendimi.

III. Kriteret, në bazë të të cilave përcaktohet kur pushon së qeni mbetje skrap i aluminit

Skrap i aluminit, që përfshin skrapin e aliazheve të aluminit, do të pushojë së qeni mbetje aty ku, me transferimin nga prodhuesi te një mbajtës tjetër, plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

¹Ky vendim transponon plotësisht rregulloren e Këshillit (BE) nr. 333/2011 të 31 marsit 2011, që vendos kriteret që përcaktojnë, kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje, sipas direktivës 2008/98/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit.



- a) mbetja e përdorur si input në operacionin e rikuperimit është në përputhje me kriteret e parashikuara në seksionin 2 të aneksit II, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) mbetjet e përdorura si input në operacionin e rikuperimit janë trajtuar në përputhje me kriteret e parashikuara në seksionin 2, të aneksit II, bashkëlidhur këtij vendimi;
- c) skrap i aluminit, që rezulton nga operacioni i rikuperimit, është në përputhje me kriteret e parashikuara në seksionin 1 të aneksit II, bashkëlidhur këtij vendimi;
- ç) prodhuesi ka plotësuar kërkesat e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të kreut V të këtij vendimi.

IV. Deklarata e konformitetit

1. Prodhuesi ose importuesi do të lëshojë, për çdo dërgesë të metalit skrap, një deklaratë të konformitetit, në përputhje me modelin e parashikuar në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Prodhuesi ose importuesi do ta transmetojë deklaratën e konformitetit te mbajtësi tjetër i dërgesës së metalit skrap. Prodhuesi ose importuesi do të mbajë një kopje të deklaratës së konformitetit, për të paktën një vit pas datës së lëshimit dhe do ta vërë atë në dispozicion të autoriteteve kompetente sipas kërkesës së tyre.

3. Deklarata e konformitetit mund të jetë në formë elektronike.

V. Menaxhimi i cilësisë

1. Një prodhues do të implementojë një sistem të menaxhimit të cilësisë, të përshtatshëm për të demonstruar përputhshmërinë me kriteret që janë përcaktuar në kërkesat 3 dhe 4 të këtij vendimi.
2. Sistemi i menaxhimit të cilësisë do të përfshijë disa procedura të dokumentuara, që kanë të bëjnë me:
 - a) kontrollin e pranimit të mbetjeve që përdoren si input për operacionin e rikuperimit, siç parashikohet në seksionin 2 të anekseve I dhe II të këtij vendimi;
 - b) monitorimin e proceseve të trajtimit dhe teknikave të përkrahura në seksionin 3.3 të anekseve I dhe II të këtij vendimi;
 - c) monitorimin e cilësisë së metalit skrap, që rezulton nga operacioni i rikuperimit, siç parashikohet në seksionin 1 të anekseve I dhe II (duke përfshirë marrjen e mostrave dhe analizën);
 - ç) efektivitetin e monitorimit të radiacionit, siç parashikohet në seksionin 1.5 të anekseve I dhe II të këtij vendimi;
 - d) vlerësimin, nga klientët, në lidhje me përputhshmërinë e cilësisë së metalit skrap;
 - dh) mbajtjen e të dhënave të rezultateve të monitorimit të kryer, sipas shkronjave “a” deri në “d” të kësaj pike;
 - e) rishikimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
 - ë) trajnimin e stafit.
3. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, gjithashtu, do të parashkruajë kërkesat e monitorimit specifik të parashikuara për çdo kriter në anekset I dhe II të këtij vendimi.
4. Kur ndonjë trajtim që përmendet në seksionin 3.3 të aneksit I ose në seksionin 3.3 të aneksit II, kryhet nga një mbajtës i mëparshëm, prodhuesi do të sigurojë që furnizuesi të zbatojë një sistem menaxhimi cilësie, i cili të përputhet me kërkesat e këtij kreu.
5. Inspektorati Shtetëror për Mjedisin është përgjegjës për të verifikuar që sistemi i menaxhimit dhe i cilësisë përputhet me kërkesat e kësaj pike. Verifikimet duhet të kryhen vazhdimisht nga Inspektorati Qendror Teknik, në përputhje me nenet 9 dhe 31 të ligjit nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”. Autoritetet doganore, për sasitë e importuara, duhet të verifikojnë cilësinë e produkteve (lëndëve të para skrap që pushojnë së qeni mbetje) në laboratorë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve.

6. Importuesi do t'u kërkojë furnizuesve të tij të zbatojnë një sistem menaxhimi cilësie, i cili të përputhet me kërkesat e pikave 1, 2 e 3 të këtij kreu dhe të verifikuar nga një verifikues i pavarur i jashtëm.

7. Prodhuesi do t'i japë Inspektoratit Shtetëror për Mjedisin akses për sistemin e menaxhimit të cilësisë, me kërkesë të tij.

VI. Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



ANEKSI I
KRITERET PËR SKRAPIN E HEKURIT DHE TË ÇELIKUT

Kriteret	Kërkesat vetëmonitoruese
<p>1. Cilësia e skrapit që rezulton nga operacioni i rikuperimit</p> <p>1.1 Skrapi do të kategorizohet sipas një specifikimi të klientit, një specifikimi të industrisë apo një standardi për përdorimin e drejtpërdrejtë në prodhimin e substancave apo të objekteve metalike nga punimet apo fonderitë e çelikut.</p> <p>1.2 Shuma totale e materialeve të huaja (sterile) do të jetë $\leq 2\%$ në peshë. Materialet e huaja janë:</p> <p>1. metalet joferrike (përrjashtuar elementet e aliazheve në substratin e metalit ferrik) dhe materialet jometalike, të tilla si: dheu, pluhuri, izolimet dhe xhami;</p> <p>2. materialet e djegshme jometalike, të tilla si: goma, plastika, pëlhura, druri dhe substanca të tjera kimike ose organike;</p> <p>3. copa më të mëdha (të madhësisë së tullës), të cilat nuk janë përcjellës të elektricitetit, të tilla si: gomat, tubat e mbushura me çimento, druri ose betoni;</p> <p>4. mbetjet që dalin nga shkrirja e çelikut, nxehja, kondicionimi i sipërfaqes (duke përfshirë lidhjen nyjë), bluarjen, sharrimin, saldimit dhe operacionet e prerjes me projektorë, të tilla si: skorje, ashkla freze, pluhur, pluhur i bluar, llumi.</p> <p>1.3. Skrapi nuk do të përmbajë oksid ferrik të tepërt në ndonjë formë, me përjashtim të shumave tipike që lindin nga magazinimi jashtë i skrapit të përgatitur në kushte atmosferike normale.</p> <p>1.4 Skrapi nuk do të ketë vaj, emulsione vaji, lubrifikantë ose graso të dukshme përrjashtuar shumat e neglizhuara që nuk çojnë në ndonjë rrjedhje.</p> <p>1.5. Radioaktiviteti dhe përmbajtja e tij në skrapet metalike do të jetë në nivelet që parashikohen në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.</p>	<p>Stafi i kualifikuar do të kategorizojë çdo dërgesë.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të kryejë një inspektim vizual të çdo dërgese. Në intervale të përshtatshme (të paktën në çdo 6 muaj), do të analizohen mostra përfaqësuese të materialeve të huaja, duke peshuar pas ndarjes magnetike ose manuale (si të jetë rasti) të pjesëzave të hekurit dhe çelikut dhe të objekteve me një inspektim vizual të kujdesshëm.</p> <p>Frekuencat e duhura të monitorimit me kampionë do të vendosen, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. modelin e pritur të variabilitetit (për shembull siç tregohet nga rezultatet historike); 2. risku i brendshëm i variabilitetit në cilësinë e mbetjeve të përdorura si input për operacionet e rikuperimit dhe ndonjë përpunim të mëvonshëm; 3. saktësimi i brendshëm i metodës së monitorimit; dhe 4. afrimi i rezultateve të limitimit të përmbajtjes së materialeve të huaja deri të një minimum prej 2% për peshë. <p>Procesi i përcaktimit të shpeshtësisë së monitorimit duhet të dokumentohet si pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe duhet të jetë në dispozicion për auditim.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të kryejë një inspektim vizual për praninë e oksideve.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të kryejë një inspektim vizual të çdo dërgese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë atyre pjesëve ku vaji ka më shumë</p>

<p>1.6. Skrapi nuk duhet të shfaqë ndonjë prej vetive të mbetjeve që i klasifikojnë ato si të rrezikshme, të përcaktuara në shtojcën 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.</p> <p>Skrapi do të jetë në përputhje me kufijtë e përqendrimit të parashikuar në anekset IV dhe V të këtij vendimi.</p> <p>Cilësitë e elementeve individuale të përfshira në aliazhet e hekurit dhe të çelikut nuk janë relevante për këtë kërkesë.</p> <p>1.7. Skrapi nuk do të përmbahet në ndonjë kontejner nën presion, të mbyllur apo të hapur në mënyrë të pamjaftueshme që mund të shkaktojnë ndonjë shpërthim në furnaltën e punimeve metalike.</p>	<p>mundësi që të pikojë.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të monitorojë radioaktivitetin e çdo dërgese.</p> <p>Çdo dërgesë skrapi do të shoqërohet nga një certifikatë që hartohet në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare për procedurat e monitorimit dhe reagimit për skrapin metalik radioaktiv. Certifikata mund të përfshihet në ndonjë dokumentacion tjetër që shoqëron dërgesën.</p>
<p>2. Mbetjet e përdorura si input për operacionin e rikuperimit</p>	
<p>2.1. Vetëm mbetjet që përmbajnë hekur ose çelik të rikuperueshëm mund të përdoren si input.</p> <p>2.2. Mbetjet e rrezikshme nuk do të përdoren si input, përveç rastit kur provohet se janë aplikuar proceset dhe teknikat e specifikuara në seksionin 3 të këtij aneksi për të larguar të gjitha cilësitë e rrezikshme.</p> <p>2.3. Mbetjet e mëposhtme që nuk do të përdoren si input janë:</p> <p>a) mbetje limimi ose tornoje që përmbajnë lëngje, të tilla si: vaji ose emulsione vaji; dhe</p> <p>b) fuçi dhe kontejner, përveç pajisjeve nga automjetet në fund të jetës, të cilët përmbajnë ose kanë përmbajtur vaj ose bojëra.</p>	<p>Kontrolli i pranimit të të gjitha mbetjeve të marra (me inspektim vizual) dhe të dokumentacionit shoqërues do të kryhen nga stafi i kualifikuar, i cili është trajnuar sesi të njohë mbetjet që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë seksion.</p>
<p>3. Proceset dhe teknikat e trajtimit</p>	
<p>3.1. Skrapi i hekurit ose i çelikut duhet të jetë i ndarë në burim ose kur mblidhet dhe duhet të mbahet i ndarë ose mbetja input duhet të trajtohet duke e ndarë skrapin e hekurit dhe të çelikut nga komponentët jometalikë dhe joferrikë.</p> <p>3.2. Të gjitha trajtimet mekanike (si: prerjet, ashklat, grisjet ose granulimet, ndarjet, ndarjet në lloje, pastrimi, heqja e ndotjes, boshatisja), që nevojitet për të përgatitur metalin skrap për input të drejtpërdrejtë në përdorimin përfundimtar në punimet dhe fonderitë e çelikut duhet të jenë të plotësuar.</p>	



3.3. Për mbetjet që përmbajnë komponentë të rrezikshëm, do të aplikohen kërkesat e mëposhtme specifike:

- a) materialet input që e kanë origjinën nga pajisjet mbetje elektrike ose elektronike ose nga automjetet në fund të jetës duhet t'u jenë nënshtruar të gjitha trajtimeve që kërkon vendimi i Këshillit të Ministrave “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve nga automjetet në fund të jetës”.
- b) klorofluorokarbonet në pajisjet e hedhura, duhet të jenë kapur në një proces të miratuar nga autoritetet kompetente;
- c) kablllo duhet të jenë të zhveshura dhe të copëtuara. Në qoftë se një kabllol përmban veshje organike (plastike), veshjet organike duhet të jenë hequr në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion;
- d) fuçitë dhe kontejnerët duhet të jenë boshatisur dhe pastruar; dhe
- e) substancat e rrezikshme në mbetje që nuk përmenden në pikën (a) duhet të jenë larguar në mënyrë eficiente në një proces që miratohet nga autoriteti kompetent.

ANEKSI II
KRITERET PËR SKRAPIN E ALUMINIT

Kriteret	Kërkesat vetëmonitoruese
<p>1. Cilësia e skrapit</p> <p>1.1 Skrapi do të shkallëzohet në përputhje me një specifikim klienti, një specifikim industrie ose një standard për përdorimin e drejtpërdrejtë në prodhimin e substancës metalike ose objektit, duke e rafinuar ose rishkrirë.</p> <p>1.2 Sasia totale e materialeve të huaja do të jetë $\leq 5\%$ për peshë ose rendimenti metalik do të jetë $\geq 90\%$;</p> <p>Materialet e huaja janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. metale të ndryshme nga alumini dhe aliazhet e aluminit; 2. materiale jometalike, të tilla si: dheu, pluhuri, materiale izolimi dhe qelqi; 3. materiale jometalike të djegshme, të tilla si: goma, plastika, pëlhura, druri dhe substanca të tjera kimike ose organike; 4. pjesë më të mëdha (madhësia e tullës), të cilat nuk janë përçuese të elektricitetit, të tilla si: goma, tubat e mbushur me çimento, druri ose betoni; ose 5. mbetjet që lindin nga shkrirja e aluminit dhe aliazheve të aluminit, nxehjes, kushtëzimit të sipërfaqes (duke përfshirë lidhjen nyjë), bluarjen, sharrimin, saldimit dhe operacionet e prerjes me projektorë, të tilla si: skorje, ashkla freze, pluhur, pluhur i bluar, llumi. <p>1.3 Skrapi nuk do të përmbajë polivinil kloridi (PVC) në formë veshjeje, bojërash plastike.</p> <p>1.4 Skrapi nuk do të ketë vaj, emulsione vaji, lubrifikantë ose graso të dukshme, përjashtuar sasi të neglizhueshme që nuk çojnë në ndonjë rrjedhje.</p> <p>1.5 Radioaktiviteti. Nuk ka nevojë për veprime reaguese në përputhje me rregullat kombëtare apo ndërkombëtare për procedurat e monitorimit dhe të reagimit për metalin skrap radioaktiv.</p>	<p>Stafi i kualifikuar do të shkallëzojë çdo dërgesë.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të kryejë një inspektim vizual të çdo dërgese.</p> <p>Në intervale të përshtatshme (të paktën në çdo 6 muaj), do të analizohen mostra përfaqësuese të materialeve të huaja, duke peshuar pas ndarjes magnetike ose manuale (si të jetë rasti) të pjesëzave të hekurit dhe të çelikut dhe të objekteve me një inspektim vizual të kujdesshëm.</p> <p>Frekuencat e duhura të monitorimit me kampionë do të vendosen, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 5. modelin e pritur të variabilitetit (për shembull siç tregohet nga rezultatet historike); 6. risku i brendshëm i variabilitetit në cilësinë e mbetjeve të përdorura si input për operacionet e rikuperimit dhe ndonjë përpunim të mëvonshëm; 7. saktësimi i brendshëm i metodës së monitorimit; dhe 8. afrimi i rezultateve të limitimit të përmbajtjes së materialeve të huaja deri të një minimum prej 2% për peshë. <p>Procesi i përcaktimit të shpeshtësisë të monitorimit duhet të dokumentohet si pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe duhet të jetë në dispozicion për auditim.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të kryejë një inspektim vizual për praninë e oksideve.</p>



<p>Kjo kërkesë nuk paragjykon standardet bazë për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe publikut, të cilat parashikohen në ligjin nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar dhe legjislacionin përkatës në Shqipëri.</p> <p>1.6 Skrapi nuk duhet të shfaqë ndonjë prej vetive të mbetjeve që i klasifikojnë ato si të rrezikshme, të përcaktuara në shtojcën 3 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.</p> <p>Skrapi do të jetë në përputhje me kufijtë e përqendrimit të parashikuar në anekset IV dhe V të këtij vendimi.</p> <p>Cilësitë e elementeve individuale të përfshira në aliazhet e aluminit nuk janë relevante për këtë kërkesë.</p> <p>1.7 Skrapi nuk do të përmbahet në ndonjë kontejner nën presion, të mbyllur apo të hapur në mënyrë të pamjaftueshme që mund të shkaktonte ndonjë shpërthim në furnaltën e punimeve metalike.</p>	<p>Stafi i kualifikuar do të kryejë një inspektim vizual të çdo dërgese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë atyre pjesëve ku vaji ka më shumë mundësi që të pikojë.</p> <p>Stafi i kualifikuar do të monitorojë radioaktivitetin e çdo dërgese.</p> <p>Çdo dërgesë skrapi do të shoqërohet nga një certifikatë që hartohet në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare për procedurat e monitorimit dhe të reagimit për metalin skrap radioaktiv. Certifikata mund të përfshihet në ndonjë dokumentacion tjetër që shoqëron dërgesën.</p>
<p>2. Mbetjet e përdorura si input për operacionin e rikuperimit</p>	
<p>2.1 Vetëm mbetjet që përmbajnë alumin ose aliazhe alumini të rikuperueshëm mund të përdoren si input.</p> <p>2.2 Mbetjet e rrezikshme nuk do të përdoren si input përveç rastit kur provohet se janë aplikuar proceset dhe teknikat e specifikuara në seksionin 3 të këtij aneksi për të larguar të gjitha cilësitë e rrezikshme.</p> <p>2.3 Mbetjet e mëposhtme nuk do të përdoren si input:</p> <p>a) mbetje limimi ose tornoje që përmbajnë lëngje, të tilla si: vaji ose emulsione vaji; dhe</p> <p>b) fuçi dhe kontejner përveç pajisjeve nga automjetet në fund të jetës, të cilët përmbajnë ose kanë përmbajtur vaj ose bojëra.</p>	<p>Kontrolli i pranimit të të gjitha mbetjeve të marra (me inspektim vizual) dhe të dokumentacionit shoqërues do të kryhen nga stafi i kualifikuar, i cili është trajnuar, se si të njohë mbetjet që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë seksion.</p>
<p>3. Proceset dhe teknikat e trajtimit</p>	
<p>3.1 Skrapi i aluminit duhet të jetë i ndarë në burim ose kur mblidhet dhe duhet të mbahet i ndarë ose mbetja input duhet të trajtohet duke e ndarë skrapin e aluminit nga komponentët metalikë joalumin.</p>	

3.2 Të gjitha trajtimet mekanike (si: prerjet, ashklat, grisjet ose granulimet, ndarjet, ndarjet në lloje, pastrimi, heqja e ndotjes, boshatisja) që nevojitet për të përgatitur metalin skrap për input të drejtpërdrejtë në përdorimin përfundimtar duhet të jenë të plotësuara.

3.3 Për mbetjet që përmbajnë komponentë të rrezikshëm, do të aplikohen kërkesat e mëposhtme specifike:

a) materialet lëndë e parë, që e kanë origjinën nga pajisjet mbetje elektrike ose elektronike ose nga automjetet në fund të jetës duhet t'u jenë nënshtruar të gjitha trajtimeve që kërkon vendimi i Këshillit të Ministrave “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve nga automjetet në fund të jetës”.

b) klorofluorokarbonet në pajisjet e hedhura duhet të jenë kapur në një proces të miratuar nga autoritetet kompetente;

c) kabllot duhet të jenë të zhveshura dhe të copëtuara. Në qoftë se një kablo përmban veshje organike (plastike), veshjet organike duhet të jenë hequr në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion;

d) fuçitë dhe kontejnerët duhet të jenë boshatisur dhe pastruar; dhe

e) substancat e rrezikshme në mbetje, që nuk përmenden në pikën (a), duhet të jenë larguar në mënyrë eficiente në një proces që miratohet nga autoriteti kompetent.



ANEKSI III
DEKLARATA E KONFORMITETIT

1	Prodhuesi/importuesi i metalit skrap: Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel. Faks: E-mail:
2	a) emri ose kodi i kategorisë së metalit skrap në përputhje me një specifikim ose standard industrie: b) aty ku është rasti, dispozitat kryesore teknike të specifikimit të një klienti, si: përbërja, madhësia, tipi dhe cilësitë:
3	Dërgesa e metalit skrap përputhet me specifikimin ose standardin që përmendet në paragrafët 3 dhe 4 të këtij vendimi:
4	Sasia e dërgesës në ton:
5	Krijohet një certifikatë e testit të radioaktivitetit në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare të monitorimit dhe procedurat e reagimit për metalin skrap radioaktiv:
6	Prodhuesi i skrapit metalik aplikon një sistem të menaxhimit të cilësisë në përputhje me paragrafin 6 të këtij vendimi, i cili është verifikuar nga një verifikues i akredituar ose, aty ku metali skrap që ka pushuar së qeni mbetje importohet në territorin doganor të bashkimit nga një verifikues i pavarur:
7	Dërgesa e metalit skrap plotëson kriteret që përmenden nga gjerat “a” deri në “c” të paragrafëve 3 dhe 4 të këtij vendimi:
8	Deklarimi i prodhuesit/importuesit të metalit skrap: Vërtetohet se informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë sipas njohurive të mija më të mira. Emri: Data: Nënshkrimi:

ANEKSI IV
PËRQENDRIMET E LEJUARA TË PËRMBAJTJES SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM NË MBETJET

Substanca	CAS No (numri i identifikimit të kimikatit, sipas nomenklaturës së kimikateve)	EC No (numri i identifikimit të kimikatit sipas Komisionit Europian)	Përqendrimet e lejuara të kimikateve në (ppm)
DDT (1,1,1-trichloro-2,2-bis (4-chlorophenyl)ethane)	50-29-3	200-024-3	50 mg/kg
Chlordane	57-74-9	200-349-0	50 mg/kg
Hexachlorocyclohexanes, perfsire lindanin	58-89-9 319-84-6 319-85-7 608-73-1	210-168-9 200-401-2 206-270-8 206-271-3	50 mg/kg
Dieldrin	60-57-1	200-484-5	50 mg/kg
Endrin	72-20-8	200-775-7	50 mg/kg
Heptachlor	76-44-8	200-962-3	50 mg/kg
Hexachlorobenzene	118-74-1	200-273-9	50 mg/kg
Chlordecone	143-50-0	205-601-3	50 mg/kg
Aldrin	309-00-2	206-215-8	50 mg/kg
Pentachlorobenzene	608-93-5	210-172-5	50 mg/kg
Polychlorinated Biphenyls (PCB)	1336-36-3 and others	215-648-1	50 mg/kg (2)
Mirex	2385-85-5	219-196-6	50 mg/kg
Toxaphene	8001-35-2	232-283-3	50 mg/kg
Hexabromobiphenyl	36355-01-8	252-994-2	50 mg/kg



ANEKSI V
NIVELET E LEJUARA TË PËRMBAJTJES SË SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME NË MBETJE

Nr.	Substanca	Përmbajtja
1	Temperatura e avullimit për të gjitha substancat në përbërje të metalit skrap	$\leq 55^{\circ}\text{C}$
2	Një ose më shumë substanca klasifikohen si shumë toksike në një koncentrim total	$\geq 0,1\%$
3	Një apo më tepër substanca klasifikohen si toksike në koncentrim total	$\geq 3\%$
4	Një apo më tepër substanca klasifikohen si të dëmshme në koncentrim total	$\geq 25\%$
5	Një apo më tepër substanca korrozive të klasifikuara si R35 në koncentrim total	$\geq 1\%$
6	Një apo më tepër substanca korrozive të klasifikuara si R34 në koncentrim total	$\geq 5\%$
7	Një apo më tepër substanca irrituese të klasifikuara si R41 në koncentrim total	$\geq 10\%$
8	Një apo më tepër substanca irrituese të klasifikuara si R36, R37, R38 në koncentrim total	$\geq 20\%$
9	Një ose më shumë substanca, njohur të jenë kancerogjene të kategorisë 1 ose 2 në një koncentrim total	$\geq 0,1\%$
10	Një ose më shumë substanca toksike për riprodhimin e kategorisë 1 ose 2 klasifikuar si R60, R61 në një koncentrim total	$\geq 0,5\%$
11	Një ose më shumë substanca toksike për riprodhimin e kategorisë 3 klasifikohen si R62, R63 në një koncentrim total	$\geq 5\%$
12	Një apo më tepër substanca mutagjene të kategorisë 1 ose 2 klasifikohen si R46 në koncentrim total	$\geq 0,1\%$
13	Një apo më tepër substanca mutagjene të kategorisë 3 klasifikohen si R40 në koncentrim total	$\geq 1\%$

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 827/7, datë 28.2.2013

**PËR BASHKËPUNIMIN NDËRINSTITUCIONAL, NË KUADËR TË REALIZIMIT TË
MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE TË PERSONAVE, TË CILËVE U KUFIZOHET LËVIZJA
ME VENDIM GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 8 pika 2 germa “gj” të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, të ndryshuar, të nenit 7 paragrafi 2 germa “c” të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, të nenit 65 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”,

UDHËZOJMË:

1. Fillimin e realizimit të procesit të mbikëqyrjes elektronike ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 4 i ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, gjykimi i të cilave është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë.

2. Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike urdhërohet nga gjykata me vendim gjyqësor, pas informimit nga Shërbimi i Provës për mundësinë teknike të realizimit të saj. Shërbimi i Provës raporton të dhënat e përditësuara për numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim, sipas pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

3. Gjatë zbatimit të projektit pilot ndaj subjekteve që gjykohen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë dhe Gjykatën e Apelit, Tiranë, mbikëqyrja elektronike vendoset vetëm ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 4 i ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”:

a) të cilët paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore, ku përfshihen personat e mitur dhe personat që akuzohen për një vepër penale që dënohet në maksimum jo më shumë se 5 vjet;

b) ndaj të cilëve është lëshuar, me vendim gjyqësor, një urdhër mbrojtjeje ose një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, sipas neneve 17 dhe 19 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar.

4. Prokurori, në kuptim të nenit 6 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, mund të kërkojë përdorimin e mbikëqyrjes elektronike vetëm për kategorinë e subjekteve të parashikuara në pikën 3.

5. Vendimi gjyqësor për vendosjen e mbikëqyrjes elektronike ekzekutohet vullnetarisht nga subjekti në mënyrën, kohën dhe vendin e caktuar nga gjykata. Vetëm në rastet e mosekzekutimit vullnetar, bëhet ekzekutimi i detyrueshëm, konform kërkesave të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar.

6. Vendimi gjyqësor për vendosjen e mbikëqyrjes elektronike i dërgohet menjëherë prokurorit, Shërbimit të Provës dhe Policisë së Shtetit. Në çdo rast, Shërbimi i Provës, menjëherë sapo njihet me vendimin gjyqësor, merr kontakte me Policinë e Shtetit, duke kërkuar bashkëpunimin për vëzhgimin e subjektit ndaj të cilit është vendosur realizimi i mbikëqyrjes elektronike, si dhe në rast se paraqitet nevoja, ndihmën e tyre për ekzekutimin e vendimit. Shërbimi i Provës i njofton menjëherë Drejtorinë së Policisë së Qarkut të dhënat mbi identitetin e subjektit, si dhe personit, i cili ka dhënë pëlqimin për t’u caktuar si person i afërt.



7. Urdhri i ekzekutimit të vendimit gjyqësor, i nxjerrë nga prokurori apo gjykata, i cili përmban vendin dhe kohën për vendosjen dhe heqjen e pajisjes, i njoftohet subjektit dhe Shërbimit të Provës. Subjekti është i detyruar të paraqitet në vendin dhe kohën e përcaktuar për vendosjen e pajisjes.

8. Nëse personi nuk paraqitet në vendin dhe kohën e përcaktuar, Shërbimi i Provës njofton menjëherë Policinë e Shtetit dhe Prokurorin.

Për subjektet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 4 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, në rast mosparaqitjeje ose shmangie nga ekzekutimi, prokurori paraqet menjëherë kërkesë për ndryshimin e masës shtrënguese ose llojit të dënimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Për subjektet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 4 të ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, Policia e Shtetit vepron forcërisht, duke vënë subjektin në dispozicion të Shërbimit të Provës, me qëllim vendosjen e pajisjes.

9. Pajisja vendoset dhe hiqet vetëm nga personat e autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës.

10. Shërbimi i Provës, menjëherë pas vendosjes së pajisjes, pasi verifikon rregullshmërinë e saj, njofton:

a) Prokurorin për fillimin e ekzekutimit të vendimit;

b) Policinë e Shtetit për fillimin e ekzekutimit të vendimit, zonën e lejuar dhe të ndaluar të lëvizjes së personit, si dhe kohën e përdorimit të ME-së, nëse gjykata urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar.

11. Prokurori mbikëqyr procedurën e vendosjes dhe të heqjes së pajisjes, rregullshmërinë e funksionimit të saj, si dhe kërkon informacione mbi ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Shërbimi i Provës informon prokurorin mbi ecurinë e mbikëqyrjes elektronike sa herë që kërkohet prej tij.

12. Shërbimi i Provës merr të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit dhe bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore. Shërbimi i Provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për subjektin nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të.

13. Kur subjekti nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, Shërbimi i Provës njofton menjëherë prokurorin. Shërbimi i Provës mund t'i propozojë prokurorit ndryshimin, sipas ligjit, të kushteve dhe detyrimeve të subjektit, pasi verifikon faktet dhe rrethanat e mospërmbushjes së tyre.

14. Në ekzekutimin e vendimit, Shërbimi i Provës mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon subjektin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në riintegrimin social të tij. Shërbimi i Provës mban kontakte të vazhdueshme telefonike, sipas metodologjisë së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, me subjektet nën mbikëqyrje elektronike, duke i kujtuar atij detyrimet ligjore për respektimin e kushteve të mbikëqyrjes elektronike, si dhe duke e inkurajuar dhe përgëzuar atë për zbatimin e këtyre kushteve.

15. Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, Shërbimi i Provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe ecurinë e procesit të mbikëqyrjes elektronike.

16. Kur subjekti nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, Shërbimi i Provës paraqet raport para prokurorit, i cili përmban informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga subjekti, vlerësimin e punonjësit të Shërbimit të Provës dhe propozimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të ndryshuar masën e vendosur, për të caktuar detyrime shtesë, për të zgjatur afatin e mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimeve për ekzekutimin e vendimit.

17. Drejtoria e Policisë së Qarkut merr të gjitha masat e nevojshme për të bashkëpunuar me Shërbimin e Provës për realizimin e mbikëqyrjes elektronike. Në rast të njoftimit nga Shërbimi i Provës për shkelje të kushteve nga subjekti, Drejtoria e Policisë së Qarkut merr masat e menjëhershme për gjetjen e personit, sipas vendndodhjes së njoftuar nga punonjësit e Sallës Operative të Mbikëqyrjes Elektronike.

18. Drejtoria e Policisë së Qarkut angazhohet duke vënë në dispozicion të punonjësve përgjegjës, për realizimin e mbikëqyrjes elektronike, numrat e tyre të kontaktit, të cilët duhet të jenë të disponueshëm në çdo kohë, duke mos cenuar procesin e mbikëqyrjes elektronike.

19. Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me vendimin e gjykatës dhe kërkesat e ligjit, të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente ose të paraqesë kërkesë në gjykatë për rivendosjen e ligjit e të së drejtës së shkelur. Prokurori i çështjes, pas marrjes së njoftimit nga Drejtoria e Shërbimit të Provës, lidhur me shkeljen e ndonjë prej kushteve/detyrimeve të dhëna në vendimin gjyqësor, merr masa për verifikimin e fakteve dhe rrethanave, ndërhyr ose paraqet kërkesën në gjykatën kompetente.

20. Punonjësit e Shërbimit të Provës dhe të Policisë së Shtetit janë të detyruar të ushtrojnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit. Ato mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe, kur është rasti, edhe penale, për mosvënien, zvarritjen e ekzekutimit të vendimit në kundërshtim me ligjin apo të drejtat e personit, si dhe për shkeljen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

21. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Prokuroria dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, i njoftojnë njëra-tjetrës dhe shkëmbejnë të dhënat e kontaktit për punonjësit përgjegjës për një komunikim të drejtpërdrejtë lidhur me procesin e mbikëqyrjes elektronike, në rastet kur paraqitet nevoja dhe urgjenca.

22. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe prokurorët pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe Gjykatës së Apelit, Tiranë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
Adriatik Llalla

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 1.3.2013
Doli nga shtypi më 1.3.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë